

VENDIM
Nr. 134, datë 7.6.2021

MBI RINOVIMIN E LICENCËS NR. 343, SERIA F16, PËR FURNIZIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SHA

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç” dhe nenit 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, grema “d”; 5, pika 1, germa “d”, 13 dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 70/2 prot., datë 10.5.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe relacionin plotësues nr. 70/2-1 prot., datë 4.6.2021, “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë ‘Devoll Hydropower’ sh.a., për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, për furnizimin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 540 prot., 9.4.2021, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 105, datë 22.4.2021, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën nr. 6/12 prot., data 22.4.2021, është bërë publikimi në median e shkruar, në lidhje me fillimin e procedurës së modifikimit të licencës nr. 343, seria F16, dhe në përfundim të afatit të njoftimit (datë 7.5.2021) nuk rezulton të ketë pasur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- Shoqëria, me shkresën nr. 540/1 prot., datë 27.4.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar për të cilin që në aplikimin e saj kishte deklaruar se do ta dorëzonte në ERE sapo ta dispononte.

- Në mbledhjen e Bordit, të datës 17.5.2021, Bordi i ERE-s vendosi të shtyjë vendimmarrjen për rinovimin e licencës nr. 343, seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për arsye se nevojitej kryerja e disa plotësimeve, në lidhje me: Deklaratën për veprimtaritë që kryen shoqëria; Strukturën e organizimit të shoqërisë; Mbajtjen e llogarive të ndara për veprimtaritë e licencuara; Kontratën e qirasë për disponimin e zyrave.

- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., me shkresën nr. 540/4 prot., datë 2.6.2021, ka paraqitur në ERE sa kërkuar më sipër.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., në fazën përfundimtare të procedurës, në bazë të nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 343, seria F16, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 10.6.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti